

20220410506

СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

L I G J

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR RROGË MINIMALE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Neni 1

Në Ligjin e Rrogës Minimale në Republikën e Maqedonisë së Veriut (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 11/12, 30/14, 180/14, 81/15, 129/15, 132/17 dhe 140/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë Veriore” nr. 124/19 dhe 239/19), në nenin 4, paragrafi (1), nënparagrafi 1 ndryshojnë si vijon:

“- 50% e rritjes së rrogës mesatare neto të paguar në Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin paraprak, sipas të dhënave të Entit Shtetëror të Statistikës, dhe

- 50% e rritjes së indeksit të shpenzimeve të jetesës për vitin paraprak, sipas të dhënave të Entit Shtetëror të Statistikës”.

Nënparagrafi 3) shlyhet.

Pas paragrafit (1), shtohen tre paragrafë të rinj (2), (3) dhe (4), që thonë:

“(2) Lartësia e rrogës minimale, e përcaktuar në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni, nuk mund të jetë më e ulët se 57% e lartësisë së rrogës mesatare neto të paguar në Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin paraprak, sipas të dhënave të Entit Shtetëror të Statistikës.

(3) Shuma mesatare e rrogës neto mujore të paguar për punonjësin që punon më pak se orari i plotë i punës përlllogaritet proporcionalisht me numrin e orëve të punës në muaj.

(4) Në shumën mesatare të rrogës neto mujore të paguar për punonjës nuk llogaritët shtesa e rrogës jashtë orarit”.

Në paragrafin (2), i cili bëhet paragrafi (5), fjalët “në muajin mars të çdo viti, që do të fillojë të paguhet me rrogën e muajit prill të vitit vijues” zëvendësohen me fjalët “në mars të çdo viti, që do të fillojë të paguhet me pagesën e rrogës për muajin mars të vitit vijues”.

Neni 2

Në kreun II-a NDIHMË FINANCIARE PËR PAGESËN E RROGËS MINIMALE DHE KONTROLLI NË REALIZIMIN DHE SHFRYTËZIMIN E NDIHMËS FINANCIARE, nenet 4-a, 4-b, 4-c, 4-ç, 4-d, 4-dh, 4-e, ndryshojnë si vijon:

“Neni 4-a

(1) Punëdhënësit i cili i plotëson kushtet nga neni 4-b i këtij ligji, do t'i sigurohet ndihmë financiare për pagesën e dallimit nga kontributet e rrogës së rritur minimale neto (në tekstin e mëtejme: ndihmë financiare) nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, për periudhën mars 2022 - dhjetor 2022, në shumë prej 1.197,00 denarë.

(2) Ndihma financiare nga paragrafi (1) i këtij neni, u sigurohet punëdhënësve për punonjësit të cilëve do t'u paguhet paga bazë deri në nivelin e rrogës bruto në shumë prej 26.422,00 denarë.

Neni 4-b

(1) Ndihma financiare nga neni 4-a i këtij ligji do t'i sigurohet punëdhënësit nëse i plotëson këto kushte:

- punëdhënësi të mos jetë i liruar nga pagesa e kontributeve të sigurimit të detyrueshëm social ose tatimit mbi të ardhurat personale për personin e punësuar nga neni 4-a, paragrafi (1) i këtij ligji;

- punëdhënësi të ketë statusin e tatimpaguesit aktiv, përkatësisht të mos jetë në procedurë falimentimi ose likuidimi ose procedurë fshirjeje, në përputhje me nenet 477, 477-a, 552-a dhe 552-b të Ligjit të Shoqërive Tregtare;

- punëdhënësi t'i ketë shlyer detyrimet mbi bazën e rrogës, kontributeve të sigurimeve sociale të detyrueshme dhe tatimeve, deri në ditën e fundit të muajit për të cilin sigurohet ndihma financiare.

(2) Ndhimja financiare nga neni 4-a i këtij ligji realizohet pas pagesës së rrogës për muajin për të cilin është siguruar ndihma financiare.

Neni 4-c

(1) Punëdhënësi në përlllogaritjen mujore për pagesë të integruar që e parashton në Drejtorinë e të Hyrave Publike, në pajtim me Ligjin e Kontributeve e Sigurimeve të Detyrueshme Sociale, i shënjon punëtorët nga neni 4-a të këtij ligji, për të cilët kërkon sigurimin e ndihmës financiare.

(2) Për të kryer pagesën e ndihmës financiare, Drejtoria e të Ardhurave Publike të dhënat e përpunuara nga paragrafi (1) të këtij neni, ia dorëzon Ministrisë së Punës dhe të Politikës Sociale, në afat prej 30 ditësh pas përfundimit të muajit për të cilin kërkohet pagesa e ndihmës financiare.

(3) Ndhimja financiare nga neni 4-a i këtij ligji paguhet përmes Ministrisë së Punës dhe të Politikës Sociale.

Neni 4-ç

(1) Mënyrën e sigurimit të ndihmës financiare nga neni 4-a i këtij ligji e përcakton ministri i Punës dhe i Politikës Sociale, në marrëveshje me Ministrinë e Financave.

Neni 4-d

(1) Punëdhënësi i cili do të përfitojë ndihmë financiare, në pajtim me dispozitat e këtij ligji, është i detyruar ta mbajë punëtorin për të cilin merr ndihmë financiare së paku një vit pas përfundimit të periudhës së marrjes së ndihmës financiare.

(2) Punëdhënësi i cili nuk do ta plotësojë kushtin nga paragrafi (1) i këtij neni, është i detyruar t'i kthejë mjetet në shumën e ndihmës financiare të fituar në pajtim me këtë ligj, në afat prej 30 ditësh nga dita e çlajmërimit të punonjësit për të cilin ka marrë ndihmë financiare, me përjashtim të rastit të realizimit të së drejtës për pension, ndërprerjes së marrëdhënies së punës për faj ose me vullnet të punonjësit ose vdekjes së punonjësit.

Neni 4-dh

Drejtoria e të Ardhurave Publike e kontrollon realizimin dhe shfrytëzimin e ndihmës financiare nga neni 4-a i këtij ligji.

Neni 4-e

Ndhimja financiare në pajtim me dispozitat e këtij ligji nuk mund të realizojë:

- tatimpaguesi i cili shfrytëzon subvencionimin e kontributeve të sigurimit të obliguar social për punonjës, në pajtim me Ligjin e Subvencionimin e Kontributeve të Sigurimit të Obliguar Social për Shkak të Rritjes së Pagave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 239/19), dhe

- tatimpaguesi që shfrytëzon masën për subvencionimin e rrogës nëpërmjet Planit operativ për programet aktive dhe masat e punësimit për punonjësit, për periudhën gjatë përdorimit të masës.

Neni 3

Lartësia e rrogës minimale në shumën bruto për pagesën e rrogës për muajin mars 2022, përfundimisht me pagesën e rrogës për muajin shkurt 2023, do të jetë në shumën e përcaktuar në nenin 2 të këtij ligji, me të cilin ndryshohet neni 4-a, paragrafi (2).

Neni 4

Dispozitat e nenit 1 të këtij ligji, me të cilat ndryshohen dispozitat e nenit 4, paragrafi (1) nënparagrafi 1) dhe 2) dhe shlyhet nënparagrafi 3), do të zbatohen gjatë përcaktimit të rrogës minimale bruto për muajin mars 2023, në bazë të lartësisë së rrogës minimale të përcaktuara në nenin 2 të këtij ligji, me të cilin ndryshohet neni 4-a, paragrafi (2).

Neni 5

Procedurat e filluara deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, në pajtim me Ligjin e Rrogave Minimale në Republikën e Maqedonisë së Veriut (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 11/12, 30/14, 180/14, 81/15, 129/15, 132/17 dhe 140/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 124/19 dhe 239/19), do të përfundojnë në pajtim me dispozitat e Ligjit të Rrogave Minimale në Republikën e Maqedonisë së Veriut (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 11/12, 30/14, 180/14, 81/15, 129/15, 132/17 dhe 140/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.124/19 dhe 239/19).

Neni 6

Akti nënligjor i paraparë me këtë ligj do të miratohet në afat prej pesë ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 7

Autorizohet Komisioni Ligjvënës Juridik i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, të caktojë tekst të spastruar të Ligjit të Rrogave Minimale në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e publikimit në „Gazetën Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“.